VENDIM
Nr. 13, datë 25.4.2026

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, "Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve", në zbatim të nenit 21/3 dhe të nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, "Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.
2. Vlera "Premio" zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.
3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare "S&P Global Platts" në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.
4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:
- 194 lekë/litri për gazoilin;
- 169 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max) për shitjen me pakicë të produkteve:
- 206 lekë/litri për gazoilin;
- 181 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, "Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoili është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.
6. Ngarkohet administra doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.
7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.
8. Në zbatim të nenit 21/8, të ligjit nr. 8450 datë 24.2.1999, "Për përpunimin, tramsportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në cilësinë e organit monitorues, ka përcjellë pranë

Bordit rastet për shkeljet e konstatuara, lidhur me vendimet e Bordit. Bordi mori vendim që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të kryejë vlerësime të thelluara lidhur me këto raste.

9. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 25.4.2026, ora 14:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

10. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Sezar Beqaj, Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Dritan Basha, Ilir Binaj, Besmir Beja, Klaudio Gega, Arlind Fida, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Nimet Veliaj